

VENDIM
Nr. 30, datë 24.1.2013

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR DREJTORINË E SHËRBIMEVE QEVERTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi prej 48 802 075 (dyzet e tetë milionë e tetëqind e dy mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekësh, për rikonstruksionin e plotë të vilës nr. 4 në Tiranë.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshilli të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha